



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË MALLAKASTËR

Nr. 3487 Prot.

Ballsh , më 03 07 /2026

VENDIM

Nr. 34 , datë 30/06/2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR
BASHKINË MALLAKASTËR ”**

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit Nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikes ne administratën publike”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror”, Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”, Urdhërin nr 211 datë 01.06.2026 të Kryetarit të bashkisë Mallakastër “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit vendor të Integritetit për bashkinë Mallakastër”

VENDOSI :

1. Të miratojë Planin e Integritetit për Bashkinë Mallakastër, për periudhën 2026-2029, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi .
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij .

Kryetar

Nexhmi Sulaj





BASHKIA MALLAKASTËR

PLANI I INTEGRITETIT

2026-2029

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operacional që bazohet në identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër. Dokumenti synon të vlerësojë nivelin e ekspozimit institucional ndaj praktikave joetike, korrupsionit dhe parregullsive administrative, si dhe të përcaktojë masat e nevojshme për parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin e tyre.

Plani i Integritetit ofron një kornizë të qartë veprimi për hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe mekanizmave të kontrollit që synojnë forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës, përmirësimin e llogaridhënies dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve publike me standarde të larta profesionale.

Ky dokument shërben gjithashtu si instrument monitorimi dhe vlerësimi për matjen e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe ndikimit të tyre në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit.

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Bashkia Mallakastër e konsideron integritetin si një nga vlerat themelore të qeverisjes së mirë dhe si një element thelbësor për garantimin e transparencës, forcimin e llogaridhënies, parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike.

Të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballët qeverisja vendore dhe për përgjegjësinë që mbartim në ofrimin e shërbimeve publike me standarde të larta profesionale, jemi angazhuar në hartimin e këtij Plani të Integritetit me synimin për të forcuar performancën institucionale, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për të konsoliduar kulturën e integritetit në administratën e Bashkisë Mallakastër.

Plani i Integritetit është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës vetëvlerësimi, të realizuar me pjesëmarrjen aktive të strukturave administrative të bashkisë dhe të koordinuar nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim. Gjatë këtij procesi u analizuan proceset kryesore të punës, me fokus të veçantë në identifikimin e fushave më të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit, praktikave korruptive dhe parregullsive administrative.

Në përfundim të procesit të vlerësimit u identifikuan dhe u analizuan risqet e integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së bashkisë, duke përcaktuar masat konkrete dhe mekanizmat e nevojshëm për menaxhimin dhe minimizimin e tyre.

Nëpërmjet zbatimit të objektivave dhe masave të parashikuara në këtë plan, Bashkia Mallakastër angazhohet të:

- Përmirësojë dhe forcojë kuadrin e brendshëm rregullator në fushën e etikës dhe integritetit;
- Zhvillojë kapacitetet institucionale dhe profesionale të burimeve njerëzore për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve të integritetit;
- Rrisë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse;
- Forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në të gjitha proceset kryesore të punës;
- Promovojë kulturën e integritetit, etikës profesionale dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e administratës bashkiake.

Bashkia Mallakastër angazhohet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Planit të Integritetit dhe të sigurojë përfshirjen aktive të të gjitha strukturave përgjegjëse në realizimin e objektivave dhe masave të përcaktuara në të.

Në këtë kuadër, shprehim përkushtimin tonë të plotë për zbatimin e këtij dokumenti strategjik, i cili do të udhëheqë përpjekjet institucionale për forcimin e integritetit, rritjen e transparencës, përmirësimin e qeverisjes vendore dhe parandalimin e korrupsionit gjatë periudhës 2026–2029.

KRYETARI I BASHKISË MALLAKASTËR

Tabela e Përmbajtjes

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	4
1. RËNDËSIA E PLANIT TË INTEGRITETIT.....	7
2.Qasja Metodologjike.....	14
3. Objektivat e Identifikuara dhe Niveli i Përgjithshëm i Cenueshmërisë së Integritetit	15
3.1 Përmirësimi i Kuadrit të Brendshëm Rregullator dhe Strategjik.....	15
3.2 Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies	16
3.3 Menaxhimi Efektiv i Riskut të Integritetit në Fusha të Veçanta të Përgjegjësisë së Bashkisë	16
4. Plani i Veprimit.....	17

Tabela e figurave

Figure 1. Gjinia e të anketuarve	10
Figure 2. Niveli i informimit për etiken	10
Figure 3. Njohja e rregullave të Integritetit.....	11
Figure 4. Fushat me risk të lartë	11
Figure 5. Njohja e mekanizmave të raportimit	12
Figure 6.Fushat që kerkohet trajnim	12

1. RËNDËSIA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit (PI) është një instrument strategjik dhe operacional që synon të sigurojë ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Bashkisë Mallakastër në përputhje me parimet e integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit. Ai përfaqëson rezultatin e procesit të identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së bashkisë dhe dëshmon angazhimin institucional për forcimin e qeverisjes së mirë dhe parandalimin e praktikave korruptive.

Plani i Integritetit ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e performancës institucionale dhe në garantimin e një administrate publike të përgjegjshme, transparente dhe të orientuar drejt interesit publik. Rëndësia e tij qëndron në disa aspekte kryesore:

- **Forcimi i integritetit institucional** – Vendos dhe promovon standarde të larta etike dhe profesionale për drejtuesit dhe punonjësit e bashkisë, duke kontribuar në krijimin e një kulture organizative të bazuar në integritet dhe përgjegjshmëri.
- **Parandalimi i korrupsionit dhe parregullsive administrative** – Nëpërmjet identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit, plani ndihmon në parandalimin e praktikave korruptive, konflikteve të interesit dhe sjelljeve joetike, duke forcuar besimin e publikut ndaj administratës vendore.
- **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies** – Plani promovon një administratë më të hapur dhe më të përgjegjshme, duke siguruar që proceset vendimmarrëse dhe veprimtaritë e bashkisë të zhvillohen në mënyrë transparente dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore** – Dokumenti parashikon masa për forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve të integritetit në ushtrimin e detyrave të tyre.
- **Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike** – Duke forcuar integritetin dhe etikën në administratë, krijohen kushtet për ofrimin e shërbimeve publike më cilësore, më efikase dhe më të besueshme për qytetarët.
- **Forcimi i marrëdhënieve me qytetarët dhe grupet e interesit** – Rritja e transparencës dhe e pjesëmarrjes qytetare kontribuon në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme besimi dhe bashkëpunimi ndërmjet bashkisë dhe komunitetit.
- **Menaxhimi efektiv i riskut** – Përmes një qasjeje sistematike dhe parandaluese, plani mundëson identifikimin dhe trajtimin në kohë të risqeve të integritetit, duke minimizuar ndikimin e tyre në veprimtarinë e institucionit.

Për hartimin e këtij dokumenti, Bashkia Mallakastër ka zhvilluar një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit të riskut të integritetit sipas fushave të përgjegjësisë. Gjatë

këtij procesi janë analizuar proceset kryesore të punës në të gjitha drejtoritë, sektorët dhe njësitë organizative të bashkisë, me fokus të veçantë në funksionet dhe pozicionet e punës më të ekspozuara ndaj risqeve të korrupsionit, konflikteve të interesit, sjelljeve joetike dhe parregullsive administrative.

Plani i Integritetit është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, me mbështetjen teknike të ekspertëve të projektit. Procesi i hartimit është bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë analizën e dokumentacionit, konsultimet me stafin dhe vlerësimin e perceptimeve të punonjësve mbi integritetin institucional.

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, Plani i Integritetit bëhet dokument detyrues për zbatim në Bashkinë Mallakastër. Qëllimi i tij është parandalimi, reduktimi dhe eliminimi i risqeve të integritetit, si dhe forcimi i mekanizmave institucionale që garantojnë etikën, transparencën dhe llogaridhënien në ushtrimin e funksioneve publike.

Nëpërmjet këtij plani synohet realizimi i objektivave të mëposhtëm:

- Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të bashkisë;
- Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore me kapacitetet e nevojshme për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit;
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë.

1.1. Procesi i Hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Mallakastër

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit përfshin identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër. Qëllimi i këtij procesi është evidentimi i faktorëve që mund të ndikojnë negativisht në efikasitetin, cilësinë dhe integritetin e proceseve të punës, si dhe përcaktimi i masave të nevojshme për parandalimin dhe menaxhimin e tyre.

Në kuadër të këtij procesi, Grupi i Punës, me mbështetjen teknike të ekspertëve të angazhuar për këtë qëllim, ka analizuar risqet e identifikuara dhe ka përcaktuar masat përkatëse për trajtimin e tyre. Vlerësimi është bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ka përfshirë proceset e punës dhe funksionet kryesore të administratës bashkiake.

Analiza është zhvilluar në shtatë fusha kryesore të veprimtarisë së bashkisë:

I. Menaxhimi financiar;

II. Menaxhimi i burimeve njerëzore;

III. Kontrolli i brendshëm, auditimi dhe mekanizmat kundër korrupsionit;

IV. Shërbimet publike;

V. Administrimi dhe menaxhimi i pronave;

VI. Planifikimi, administrimi dhe zhvillimi i territorit;

VII. Arkivimi, ruajtja dhe administrimi i dokumenteve, informacionit dhe dokumenteve elektronike.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Mallakastër është realizuar në katër faza kryesore:

Faza I – Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Procesi filloi me angazhimin institucional të Bashkisë Mallakastër për hartimin e Planit të Integritetit, nëpërmjet nxjerrjes së Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 211, datë 01.06.2026, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit”.

Në zbatim të këtij urdhri u ngrit Grupi i Punës, i përbërë nga drejtues dhe punonjës të strukturave të ndryshme të bashkisë, që mbulojnë fushat kryesore të përgjegjësisë institucionale.

Në këtë fazë u prezantua metodologjia e planifikimit të integritetit, u përcaktuan rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në proces, si dhe u informua administrata e bashkisë mbi qëllimin, objektivat dhe rëndësinë e Planit të Integritetit.

Faza II – Identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit

Në këtë fazë u realizua identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit në nivel institucional. Procesi përfshiu:

- Vlerësimin e kuadrit të brendshëm rregullator dhe procedural të bashkisë;
- Organizimin e grupeve të diskutimit (fokus-grupeve) me përfaqësues të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm;
- Administrimin e një pyetësoi anonim për punonjësit e bashkisë;
- Analizimin e të dhënave të mbledhura për të evidentuar faktorët që mund të cenojnë integritetin institucional.

Nëpërmjet këtij procesi u identifikuan fushat më të ekspozuara ndaj korrupsionit, konfliktit të interesit, mungesës së transparencës dhe parregullsive administrative.

➤ Analiza e rezultateve të pyetësorit

Shpërndarja sipas gjinisë

Numri i të anketuarve sipas gjinisë.




Figure 1. Gjinia e të anketuarve

Në pyetësor morën pjesë 50 punonjës. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë femra, ndërsa grupmosha dominuese është 26–45 vjeç.

Niveli i informimit për etikën

Perceptimi i punonjësve mbi njohjen e rregullave të etikës.




Figure 2. Niveli i informimit për etikën

Njohja e rregullave të integritetit

Përgjigjet për ekzistencën e rregullave dhe procedurave të integritetit.




Figure 3. Njohja e rregullave të Integritetit

Rezultatet tregojnë një nivel të lartë ndërgjegjësimi mbi etikën dhe integritetin. Shumica e punonjësve deklarojnë se janë të informuar ose shumë të informuar dhe njohin procedurat përkatëse. Shumica e të anketuarve vlerësojnë pozitivisht transparencën dhe trajtimin e barabartë në institucion.

Fushat me risk më të lartë

Fushat ku perceptohen risqe më të larta korrupsioni.



Figure 4. Fushat me risk të lartë

Sipas perceptimit të punonjësve, risqet më të larta lidhen me prokurimet publike dhe menaxhimin financiar, fusha të cilat kërkojnë monitorim dhe masa parandaluese të vazhdueshme.

Njohja e mekanizmave të raportimit

A dinë punonjësit ku të raportojnë raste të dyshuara korrupsioni?




Figure 5. Njohja e mekanizmave te raportimit

Pjesa më e madhe e punonjësve deklarojnë se dinë ku të raportojnë një rast të dyshuar korrupsioni, megjithëse mbetet e nevojshme forcimi i besimit mbi mbrojtjen e raportuesve.

Fushat ku kërkohet trajnim

Temat që punonjësit konsiderojnë prioritare për trajnim.




Figure 6. Fushat qe kerkohet trajnim

Punonjësit identifikojnë menaxhimin e riskut, etikën në administratë dhe antikorruptionin si fushat kryesore ku nevojiten trajnime të mëtejshme.

Faza III – Vlerësimi i risqeve të integritetit

Pas identifikimit të risqeve, u krye vlerësimi i tyre duke marrë në konsideratë probabilitetin e ndodhjes dhe ndikimin që secili risk mund të ketë në funksionimin e institucionit.

Në këtë fazë u përcaktuan risqet prioritare që kërkojnë ndërhyrje, duke u bazuar në nivelin e ekspozimit të bashkisë dhe në kapacitetet ekzistuese për menaxhimin e tyre. Risqet u renditën sipas nivelit të prioritetit, me qëllim orientimin e burimeve institucionale drejt trajtimit të tyre në mënyrë efektive.

Faza IV – Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Integritetit

Bazuar në rezultatet e analizës dhe vlerësimit të risqeve, Grupi i Punës hartoi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integritetit, i cili përmban masat konkrete për forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të menaxhimit.

Plani i Veprimit parashikon ndërhyrje në fusha të ndryshme, duke përfshirë:

- Përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator;
- Zhvillimin profesional dhe trajnimin e burimeve njerëzore;
- Rritjen e transparencës dhe aksesit në informacion;
- Përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit;
- Digjitalizimin e proceseve dhe dokumentacionit;
- Forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.

Analiza e zbatimit të Planit të Integritetit 2022–2025 evidentoi nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të risqeve të integritetit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, zgjerimin e kanaleve të raportimit të shkeljeve, si dhe përfshirjen më të madhe të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Gjithashtu u identifikua nevoja për vendosjen e indikatorëve të matshëm të performancës dhe raportim periodik mbi zbatimin e masave të planit.

Për secilën masë janë përcaktuar aktivitetet konkrete, afatet e zbatimit, strukturat përgjegjëse dhe treguesit e monitorimit, me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të planit.

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, Plani i Integritetit bëhet dokument detyrues për zbatim në Bashkinë Mallakastër dhe do të shtrihet në periudhën 2026–2029.

2.Qasja Metodologjike

Në procesin e hartimit të Planit të Integritetit, Grupi i Punës zbatoi dy metoda kryesore për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e cënueshmërisë së integritetit: metodën cilësore dhe metodën sasiore.

- Në fazën fillestare u organizua një sesion trajnimi me anëtarët e Grupit të Punës dhe punonjësit e Bashkisë Mallakastër mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Ky proces synoi krijimin e një kuptimi të përbashkët mbi konceptet, parimet dhe hapat metodologjikë të planifikimit të integritetit.
Në kuadër të metodës cilësore, u realizua analiza e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të bashkisë, përmes shqyrtimit të dokumentacionit ekzistues, si urdhra, rregullore, manuale, strategji, plane veprimi, dokumente politikash dhe akte të tjera të brendshme. Gjithashtu, u analizuan raporte të ndryshme të brendshme dhe të jashtme që lidhen me veprimtarinë e institucionit.
- Një komponent i rëndësishëm i analizës cilësore ishte zhvillimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga gjashtë fokus-grupe (grupe diskutimi) me përfaqësues të drejtorive dhe strukturave të ndryshme të bashkisë. Këto diskutime shërbyen për identifikimin e ngjarjeve negative në proceset e punës, praktikave që mund të cenojnë integritetin institucional, si dhe funksioneve dhe pozicioneve të punës më të ekspozuara ndaj korrupsionit, sjelljeve joetike, joprofesionale dhe parregullsive të tjera administrative.
- Paralelisht me metodën cilësore, u përdor edhe metoda sasiore përmes administrimit të një pyetësi elektronik anonim dhe të strukturuar. Pyetësi përfshinte pyetje të fokusuara në aspekte të etikës, integritetit institucional, transparencës, llogaridhënies dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Qëllimi i këtij instrumenti ishte matja e perceptimeve të punonjësve lidhur me sistemin e menaxhimit të integritetit në bashki dhe identifikimi i fushave që kërkojnë ndërhyrje për përmirësim.

Anketimi u realizua mbi bazën e pjesëmarrjes vullnetare dhe anonime të punonjësve, duke garantuar konfidencialitetin e përgjigjeve. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u mbështet në parimin e vullnetarizmit dhe synoi të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të strukturave administrative të Bashkisë Mallakastër. Të dhënat e mbledhura shërbyen për vlerësimin e perceptimeve të punonjësve mbi etikën, integritetin, transparencën, risqet e korrupsionit, mekanizmat e raportimit dhe nevojat për trajnim. Në pyetësor morën pjesë 50 punonjës. Femrat përbënin rreth 72% të të anketuarve, ndërsa meshkujt rreth 26%. Të dhënat e mbledhura nga pyetësi, fokus-grupet dhe analiza dokumentare u përpunuan

dhe u analizuan nga Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit. Rezultatet evidentuan një nivel të mirë njohjeje të rregullave të etikës dhe integritetit, por gjithashtu identifikuan fusha që kërkojnë vëmendje të shtuar, veçanërisht në drejtim të menaxhimit të riskut, transparencës institucionale, forcimit të mekanizmave të raportimit dhe monitorimit të proceseve me ekspozim më të lartë ndaj risqeve të integritetit. Këto gjetje shërbyen si bazë për identifikimin, vlerësimin dhe prioritizimin e risqeve, si dhe për hartimin e masave konkrete të parashikuara në Planin e Integritetit të Bashkisë Mallakastër 2026–2029.

3. Objektivat e Identifikuara dhe Niveli i Përgjithshëm i Cenueshmërisë së Integritetit

3.1 Përmirësimi i Kuadrit të Brendshëm Rregullator dhe Strategjik

Ky objektivi synon forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e efektivitetit të qeverisjes vendore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të Bashkisë Mallakastër. Arritja e këtij objektiivi do të realizohet përmes rishikimit, përditësimit dhe harmonizimit të dokumenteve të brendshme rregullatore me legjislacionin në fuqi, standardet e integritetit publik dhe parimet e qeverisjes së mirë.

Procesi i vlerësimit të riskut evidentoi nevojën për përmirësimin e disa instrumenteve të brendshme rregullatore dhe strategjike, me qëllim adresimin e boshllëqeve të identifikuara dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Në këtë kuadër, do të ndërmerren masa për hartimin, rishikimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe procedurale që lidhen me etikën, integritetin, menaxhimin e riskut, transparencën dhe llogaridhënien institucionale.

Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet hartimit dhe zbatimit të dokumenteve strategjike afatmesme dhe afatgjata, si Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional, Strategjia e Administrimit të Pronave dhe Strategjia e Menaxhimit të Riskut, të cilat do të kontribuojnë në konsolidimin e një sistemi administrativ më të qëndrueshëm, transparent dhe efektiv.

Zbatimi i këtij objektiivi pritet të forcojë bazën rregullatore të institucionit, të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes administrative dhe të rrisë nivelin e besimit të qytetarëve ndaj Bashkisë Mallakastër. Një kuadër i përditësuar dhe funksional do të mbështesë më tej krijimin e një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore për komunitetin.

3.2 Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies

Ky objektiv synon forcimin e transparencës institucionale dhe rritjen e llogaridhënies së Bashkisë Mallakastër ndaj qytetarëve, duke promovuar një administratë të hapur, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt interesit publik. Transparenca dhe llogaridhënia përbëjnë elemente themelore të qeverisjes së mirë dhe janë faktorë kyç për rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve vendore.

Për realizimin e këtij objekti do të ndërmerren masa për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të Programit të Transparencës, rritjen e aksesit të qytetarëve në informacionin publik, si dhe publikimin në kohë dhe në mënyrë të plotë të dokumenteve me interes publik, përfshirë buxhetin e bashkisë, vendimet e Këshillit Bashkiak, raportet e monitorimit dhe dokumentet e konsultimit publik.

Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet forcimit të komunikimit me qytetarët dhe nxitjes së pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse përmes konsultimeve publike, platformave elektronike dhe mekanizmave të tjerë të ndërveprimit me komunitetin. Kjo do të mundësojë një dialog më të hapur ndërmjet administratës dhe qytetarëve, duke garantuar që vendimmarrja të jetë më gjithëpërfshirëse dhe më e orientuar drejt nevojave të komunitetit.

Objektivi përfshin gjithashtu krijimin dhe përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të performancës institucionale. Raportimi periodik mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe mbi rezultatet e arritura do të kontribuojë në rritjen e përgjegjshmërisë së administratës dhe në forcimin e kontrollit publik mbi veprimtarinë e saj.

Zbatimi i këtij objekti pritet të kontribuojë në krijimin e një kulture organizative të bazuar në transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet, duke rritur besimin e qytetarëve ndaj Bashkisë Mallakastër dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike të ofruara.

3.3 Menaxhimi Efektiv i Riskut të Integritetit në Fusha të Veçanta të Përgjegjësisë së Bashkisë

Ky objektiv synon forcimin e kapaciteteve institucionale për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së Bashkisë Mallakastër. Qasja e bazuar në menaxhimin e riskut synon parandalimin e korrupsionit, shmangien e parregullsive administrative dhe garantimin e zbatimit të standardeve të integritetit në të gjitha proceset e punës.

Vlerësimi i kryer në kuadër të hartimit të Planit të Integritetit identifikoi disa fusha me nivel më të lartë ekspozimi ndaj risqeve të integritetit, duke përfshirë menaxhimin financiar, administrimin e pronave publike, ofrimin e shërbimeve publike, prokurimet, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe administrimin e dokumentacionit dhe arkivës. Në këto fusha janë evidentuar sfida që lidhen me kufizimet në burimet financiare

dhe njerëzore, nevojën për përmirësimin e procedurave të brendshme, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologjike dhe sistemeve të kontrollit.

Për adresimin e këtyre sfidave do të ndërmerren masa për përmirësimin e procedurave administrative, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, rritjen e monitorimit të proceseve me risk të lartë dhe zhvillimin e sistemeve periodike të raportimit dhe vlerësimit. Gjithashtu, do të promovohen praktika të mira të menaxhimit të riskut dhe do të rritet ndërgjegjësimi i punonjësve për rëndësinë e integritetit në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Nëpërmjet zbatimit të këtij objekti synohet krijimi i një administrate proaktive, të aftë për të identifikuar dhe adresuar risqet përpara se ato të materializohen në shkelje të integritetit ose në pasoja negative për institucionin. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, rritjen e efikasitetit institucional dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj Bashkisë Mallakastër.

Menaxhimi efektiv i risqeve të integritetit do të mbështesë konsolidimin e një administrate vendore transparente, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt standardeve më të larta të qeverisjes së mirë, duke garantuar përdorimin e drejtë dhe efektiv të burimeve publike në interes të komunitetit.

4. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfaqëson tërësinë e masave konkrete të hartuara për adresimin e risqeve dhe faktorëve të cenueshmërisë së integritetit, të identifikuar dhe vlerësuara sipas fushave të përgjegjësisë së Bashkisë Mallakastër. Ky plan shërben si një instrument operacional në mbështetje të politikave dhe kuadrit rregullator institucional, me qëllim forcimin e integritetit, transparencës dhe efikasitetit të administratës vendore.

Zbatimi i Planit të Veprimit shoqërohet nga një proces i vazhdueshëm monitorimi dhe raportimi, i cili realizohet në mënyrë periodike dhe sistematike. Gjatë periudhës së zbatimit të Planit të Integritetit, hartohen raporte të ndërmjetme monitorimi, si dhe një raport përfundimtar në përmbyllje të ciklit të zbatimit 2026–2029. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave të parashikuara dhe efektivitetin e tyre në menaxhimin e risqeve të integritetit.

Monitorimi i Planit të Veprimit realizohet minimalisht në baza vjetore, ndërsa raportimi mbi progresin e zbatimit kryhet çdo gjashtë muaj. Ky proces synon të evidentojë nivelin e përmbylljes së aktiviteteve nga strukturat dhe punonjësit përgjegjës, si dhe të identifikojë në kohë çdo devijim nga objektivat e përcaktuara.

Nëpërmjet procesit të monitorimit vlerësohet efektiviteti i masave të zbatuara, si dhe identifikohen ndryshimet eventuale në kontekstin institucional ose në profilin e risqeve të integritetit. Në rast nevojë, ky proces mundëson rishikimin e masave ekzistuese,

rishpërndarjen e prioriteteve dhe përditësimin e Planit të Veprimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve institucionale.

Raportimi përbën një procedurë të rregullt të brendshme administrative, përmes së cilës sigurohet ndjekja sistematike e zbatimit të masave të Planit të Integritetit brenda afateve të përcaktuara. Për këtë qëllim, caktohet një person përgjegjës nga titullari i institucionit, i cili mbikëqyr dhe koordinon procesin e raportimit dhe monitorimit të progresit.

Raportet e monitorimit i paraqiten Këshillit Bashkiak si organi vendimmarrës që ka miratuar Planin e Integritetit dhe publikohen në Programin e Transparencës së Bashkisë Mallakastër, në përputhje me parimet e hapjes dhe llogaridhënies publike.

Ky sistem i monitorimit dhe raportimit kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të zbatimit të Planit të Integritetit, rritjen e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe forcimin e kulturës institucionale të përgjegjshmërisë dhe integritetit.

Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik

Nr	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1.	Rregulloret e brendshme nuk përditësohen sipas ndryshimeve ligjore	Organizativ / Ligjor	I lartë	Rishikimi i të gjitha rregulloreseve dhe procedurave të brendshme; harmonizimi me legjislacionin në fuqi	Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike – 6 muajt 2026
2.	Rregullorja e administratës së bashkisë Mallakastër e pa përditësuar me ndryshimet në strukturën e Bashkisë, sjell mos parashikimin e përshkrimeve të të gjitha pozicioneve të punës dhe linjave hierarkike përkatëse (struktura e bashkisë është e miratuar, por nuk është e përditësuar).	Organizativ / Burime Njerëzore	I lartë	Rishikimi i rregullores me qëllim përfshirjen e përshkrimeve për të gjitha pozicionet e punës të pasqyruara në strukturën e Bashkisë	Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike – 6 muajt i II 2026
3.	Mungesa e procedurave të standardizuara për menaxhimin e riskut të integritetit	Organizativ	I lartë	Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së menaxhimit të riskut	Koordinatori i Integritetit mujori i dytë 2026

4.	Dokumentet strategjike duhet të monitorohen periodikisht	Menaxherial	Mesatar	Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe raportimit vjetor	Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e planifikimit , 2026-2029
5.	Mungesa e një strategjie të miratuar dhe të unifikuar për administrimin e pronave bashkiake."	Operacional / Procesi	I lartë	Hartimi, konsultimi, miratimi dhe publikimi i strategjisë së administrimit të pronave bashkiake.	Grupi i punës për hartimin e strategjisë së administrimit të pronave të bashkisë / Koordinatori për të Drejtën e Informimit / Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik 2026–2027

6.	Mungesa e regjistrimit të dhuratave mund të sjellë mos deklarimin e dhuratave të marra nga punonjësit dhe vështirësi në monitorimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit.	Operacional / Ligjor dhe kontraktual	Mesatar	1. Krijimi i regjistrimit të dhuratave në bashki. 2. Informimi i punonjësve të bashkisë në lidhje me krijimin e regjistrimit dhe detyrimet përkatëse për deklarimin e dhuratave. 3. Monitorimi dhe përditësimi i regjistrimit të dhuratave	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike / Sekretari i Përgjithshëm Tremujori II 2026 Drejtoria e Burimeve Njerëzore Tremujori III 2026 Drejtoria e Burimeve Njerëzore Në vijimësi (2026–2029)
7.	Mungesa e procedurave të standardizuara për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve lidhur me administrimin e pronave bashkiake mund të sjellë vonesa, trajtim jo të njëjtë të rasteve dhe mungesë transparence.	Operacional / Informacioni	Mesatar	1. Hartimi i procedurave të brendshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve rreth administrimit të pronave bashkiake 2. Publikimi dhe zbatimi i procedurës	Sektori i Menaxhimit Sektori i Çështjeve Juridike / Koordinatorin për të drejtën e informimit Tremujori III 2026 Tremujori IV 2026
8.	Mungesa e një regjistri të konsoliduar dhe të përditësuar të riskut për të gjitha drejtoritë dhe sektorët mund të sjellë mosidentifikim dhe mosmonitorim efektiv të risqeve institucionale.	Operacional / Strategjik	I Lartë	1. Hartimi dhe publikimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut. 2. Identifikimi dhe dokumentimi i risqeve nga çdo drejtori dhe sektor. 3. Përditësimi periodik i regjistrimit dhe raportimi te titullari i institucionit.	Koordinatori i Menaxhimit të Riskut Tremujori II 2026 Drejtuesit e drejtorive dhe sektorëve Tremujori III 2026 Çdo vit (2026–2029)

9.	Mungesa e harmonizimit ndërmjet rregullores së Këshillit Bashkiak dhe	Operacional/ Strategjik	1.	Rishikimi i rregullores së Këshillit Bashkiak dhe akteve të	Drejtoria Juridike / Sekretari i Këshillit Bashkiak, Tremujori II
Nr Risku dhe ngjarjet e mundshme		Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e mases	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
12.	Permiresimi i njohurive teknike për ndryshimet e shpeshta ligjore/nënligjore në fushën e prokurimit publik.	Burime Njerëzore Operacional	Mesatar	Zhvillimi i trajnimeve periodike mbi etikën, konfliktin e interesit dhe antikorrupsionin	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, 2026-2029
13.	Punonjësit duhet të identifikojnë dhe raportojnë në mënyrë efektive risqet e integritetit, duke sjellë mosparandalimin në kohë të rasteve të mundshme të konfliktit të interesit, shkeljeve etike ose praktikave korruptive.	Burime Njerëzore	I lartë	1. Organizimi i trajnimeve periodike mbi identifikimin dhe raportimin e risqeve të integritetit. 2. Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi praktik për raportimin e risqeve. 3. Informimi i punonjësve mbi mekanizmat e raportimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. 4. Vlerësimi periodik i nivelit të ndërgjegjësimit të stafit.	Koordinatori i Integritetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Trajnimet fillestare deri në Tremujorin III 2026; përditësimi dhe zhvillimi i tyre në vijimësi gjatë periudhës 2026-2029.
14.	Domosdoshmëri për përf forcimin e njohurive të punonjësve për proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin e sistemeve elektronike financiare.	Burime Njerëzore Operacional	I mesëm	Hartim i një plani trajnimesh në nivel drejtues dhe programesh mbi procesin hartimit të PBA-së, nëpërmjet transferimit të brendshëm të njohurive.	Drejtoria e Financës / IT / Burimet Njerëzore 2026-2027 (me përditësim në vijimësi)

Objekti 2: Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë me aftësi të nevojshme për identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

15.	Rregullorja e administratës duhet të përditësohet me strukturën aktuale	Organizativ	I lartë	Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores së Administratës dhe përshkrimeve të punës	Sekretari i Përgjithshëm / Drejtoria e Burimeve Njerëzore / Juridik Tërmujori I II – Tërmujori IV- 2026
16.	Nevojë për njohuri shtesë të punonjësve të njësisë së integritetit evropian lidhur me procedurat e aplikimit për përfitim të projekteve nga B.E	Burime Njerëzore/ Procesi	I mesëm	1. Ofrimi i trajnimeve të personelit të njësisë së integritetit evropian, financës dhe sektorit juridik, në këtë fushë	Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijimësi

Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Nr	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e mases	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
17.	Mungesa e publikimit të raporteve të Auditit të Brendshëm në Programet e Transparencës.	Operacional Procesi	I mesëm	Publikimi i raporteve të meknizhave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm në faqen zyrtare të bashkisë.	Auditi/Koordinatori për të drejtën e informimit Gjashtëmujori i parë 2027 e në vijimësi
18.	Informacioni nuk publikohet në kohë në faqen zyrtare	Transparencë	I lartë	Përditësimi periodik i Programit të Transparencës dhe publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë	Koordinatori për të Drejtën e Informimit Në vijimësi (raportim mujor, 2026–2029)
19.	Mungesë e mekanizmeve efektive të trajtimit të ankesave	Llogaridhënie	I lartë	Krijimi i sistemit të monitorimit të ankesave dhe raportimit periodik	Drejtorja e Shërbimeve ndaj Qytetarëve ,2026-2029

20.	Pjesëmarrje e ulët e publikut në proceset e konsultimit të paketës fiskale.	Operacional/ Informacioni	I mesëm	Organizimi i fushatave të përgjithshme ndërgjegjëse duke përdorur mediat sociale të bashkisë, për të nxitur pjesëmarrjen e publikut në proceset e konsultimit publik.	Koordinatori për Konsultimin Publik – 2026-2029
21.	Pjesëmarrje e ulët e publikut në proceset e konsultimit publik të dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.	Operacional/Procesi	I mesëm	Organizimi i proceseve transparente dhe gjithëpërfshirëse të konsultimit publik në lidhje me dokumente vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit.	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Koordinatori për të drejtën e informimit Tremujori i III 2026 në vazhdimësi
22.	Informacion jo i plotë për publikun dhe ndërgjegjësim i ulët i qytetarëve në lidhje me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejeve dhe licencave; detyrimet ligjore që shoqërojnë veprimtarinë ndërtimore; penalitetet që shoqërojnë ndërtimet pa leje.	Operacional/Procesi	I mesëm	Publikimi i informacionit të plotë dhe të kuptueshëm për publikun në Programin e Transparencës të bashkisë në lidhje me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejeve dhe licencave; detyrimet ligjore që shoqërojnë veprimtarinë ndërtimore dhe penalitetet përkatëse.	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Koordinatori për të drejtën e informimit tre mujori i III 2026 në vazhdimësi

Objekti 4: Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Nr	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
Fusha: Prokurimet Publike					
23.	Inventari i pronave bashkiake është i paazhurnuar. Ka mospërputhje mes dokumenteve të regjistrimit fillestar të pronave me situatën faktike. Inventarizimi i pronave bazohet në hartë kadastrale të vjetër dhe të pa azhurnuar.	Operacional/ Strategjik	I lartë	1. Ngritja e një grupi pune për inventarizimin e pronave. 2. Prioritizimi i procesit të azhurnimit të dokumenteve të regjistrimit fillestar me situatën faktike të pronave të bashkisë. Inventarizimi i pronave aktuale të bashkisë. 3. Publikimi i informacionit të përditësuar	Grupi i punës për inventarizimin e pronave/ Koordinatori për të drejtën e informimit gjashtëmujori i parë -2027
24.	Programi informatik duhet i unifikuar për menaxhimin e aktiviteteve të bashkisë.	Operacional Procesi/ Teknologjia e informacionit	I lartë	1. Sigurimi i një programi informatik të unifikuar për menaxhimin e aktiveve të bashkisë. 2. Trajnimi i personelit përkatës në lidhje me përdorimin e këtij programi.	Sektori i Menaxhimit të Pronave / Drejtoria Ekonomike/ Specialisti i IT/ 2026-2027
25.	Mungesa logjistike (komputera dhe programe sisteme të specializuara) për arkitektët dhe inxhinierët.	Operacional/ Procesi	I mesëm	Marrja e masave për planifikimin e shpenzimeve buxhetore për plotësimin e nevojave logjistike (komputera dhe programe sisteme të specializuara) për arkitektët dhe inxhinierët	Drejtoria Ekonomike 2026

26.	Favorizim i operatorëve ekonomikë gjatë procedurave	Korrupsion / Konflikt interesi	I lartë	Kontrollet e brendshme dhe deklarimi i konfliktit të interesit	Njësia e Prokurimit ,2026-2029
27.	Transparencë e pamjaftueshme mbi zbatimin e kontratave	Operacional/Procesi	I lartë	Publikimi i kontratave dhe monitorimi i realizimit të tyre	Njësia e Prokurimit – 2026-2029
Fusha: Menaxhimi i Financave					
28.	Domosdoshmëri për përmirësim në kontrollin financiar të brendshëm	Operacional/Procesi	I lartë	Forcimi i kontrolleve dhe auditimeve të brendshme	Drejtoria e Financës – 2026-2029
29.	Mungesa e monitorimit të shpenzimeve me risk të lartë Detyrime të papaguara të prapambetura ndaj bashkisë nga të tretët.	Operacional/Procesi	I mesëm	Analiza periodike e shpenzimeve dhe raportim te drejtuesit	Drejtoria e Financës – çdo 6 muaj 2026-2029
Fusha: Shërbimet për Qytetarët					

30.	Kapacitete të kufizuara financiare, burimesh njerëzore dhe teknike për realizimin e funksioneve të shërbimeve publike (kryesisht) në nivel Njësish Administrative	Operacional/Procesi	I lartë	Analizë e kapaciteteve ekzistuesve dhe hartimi sipas prioriteteve i planifikimit për shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike	Kryetari/Grup Pune Drejtoria e Shërbimeve – 2027 - 2029
31.	Mungesa e manualeve të brendshme për procesin e mbikqyrjes dhe monitorimit të Shërbimeve publike.	Operacional/Procesi	I mesëm	Grup pune me punonjës të bashkisë për hartimin dhe miratimin e metodologjisë së monitorimit të performancës së shërbimit.	Grup pune, Gjashtëmujori i parë- 2026